



Kontrolli i Lartë i Shtetit

BULETINI STATISTIKOR
NR.2

Periudha
JANAR – QERSHOR 2020

Buletini nr. 2

Janar - Qershor
2020

Buletini i dytë statistikor i vitit 2020, përmbledh rezultatet e të gjitha auditimeve të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në periudhën janar – qershor 2020. Në këtë buletin përfshihen, dëmi ekonomik i konstatuar, të ardhurat e munguara dhe shpenzimet e kryera jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit (3E), masat disiplinore dhe administrative të rekomanduara, si edhe kallëzimet penale të përcjella në Prokurori.

Buletini përgatitet nga Drejtoria e Komunikimit, Botimeve dhe e Marrëdhënieve me Jashtë (sektori i statistikës).

K Kontrolli i Lartë i Shtetit.


	KLSH DHE AKTIVITETI AUDITUES PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR TË VITIT 2020 (BULETINI STATISTIKOR NR.2)	Faqe
I	TREGUESIT KRYESORË TË VEPRIMTARISË AUDITUESE	3
II	Shkeljet me dëm ekonomik	10
II.a	<i>Shkeljet me dëm ekonomik: Në fushën e të ardhurave</i>	11
	Në sektorin e Tatim-Taksave	12
	Në sektorin e doganave	13
	Në fushën e shitjes, blerjes dhe dhënies me qira të pasurisë shtetërore, marrëveshjeve hidrokarbure dhe kontratave koncensionare	14
	Në fushën të tjera	14
II.b	<i>Shkeljet me dëm ekonomik: Në fushën e shpenzimeve</i>	15
	Në fushën e pagave, shpërblimeve dhe sigurimeve shoqërore	16
	Në fushën e prokurimeve	16
	Në fushën e shpenzimeve operative	19
	Në fushën të tjera	19
III	Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara	19
III.1	Në fushën e të ardhurave	20
III.2	Në fushën e shpenzimeve	24
IV	Auditimet me opinion	30
IV.1	Dhënie opinionit për auditimet financiare	31
IV.2	Dhënie opinionit për auditimet e përputhshmërisë	31
IV.3	Dhënie opinionit mbi pasqyrat financiare dhe opinion mbi përputhshmërinë	32
V	Auditimet e Teknologjisë së Informacionit	33
VI	Rekomandimet sipas natyrës	35
VII	Kallëzimet penale	38
	Anekse	
1	Institucionet e evaduar nga KLSH, gjatë periudhës Janar – Qershor 2020	40
2	Evidenca përmbledhëse e shkeljeve me dëm ekonomik	43
3	Evidenca e pasqyrimit të parregullsive të dispozitave ligjore në fuqi, për të ardhura të munguara ose shpenzime jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit	43
4	Masat Disiplinore dhe Administrative	44
5	Masat për Ndryshime apo Përmirësime ligjore	45
5.1	Masat Organizative	45
6	Kallëzimet Penale	47
7	Evidenca e ankesave dhe kërkesave drejtuar KLSH	49

KLSH DHE AKTIVITETI AUDITUES NË PERIU DHËN JANAR – QERSHOR 2020

I. TREGUESIT KRYESORË TË VEPRIMTARISË AUDITUESE

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën Janar – Qershor 2020, ka zhvilluar 89 auditime nga të cilat: 34 misione auditimi janë evaduar dhe 55 auditime janë në proces.

34 misionet e auditimit të evaduara janë detajuar si më poshtë:



Niveli i dëmeve ekonomike dhe shpenzimeve joefektive të konstatuara nga KLSH gjatë periudhës Janar – Qershor paraqitet si më poshtë:

Shkeljet me dëm ekonomik



Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej 2,178,898 mijë lekë ose 17,5 milionë euro.



Indikatori i dobisë së auditimit (raporti i dëmeve të zbuluara nga KLSH në vlerën 2,178,898,000 lekë (17,5 milionë euro) me shpenzimet buxhetore faktike të KLSH-së në vlerën 175,028,241 lekë) është 12,4.



Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej 2,276,488 mijë lekë, afërsisht 18.3 milionë euro nga e cila:

I. 1,058,199 mijë lekë në fushën e të ardhurave, afërsisht 8,5 milionë euro;

II. 1,218,289 mijë lekë afërsisht 9,8 milionë euro, në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve, si dhe shkelje të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve, keqmenaxhimin e fondeve të programuara apo mungesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor.



Puna audituese është përqëndruar kryesisht në fushat për të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vlerësuar një nivel të lartë risku. Edhe gjatë kësaj periudhe, shkeljet më të mëdha me efekte të konsiderueshme në buxhetin e shtetit dhe jo vetëm, lidhen me administrimin e të ardhurave: menaxhimin jo të kujdesshëm në procesin e përdorimit të fondeve publike; keq administrimin e pronës shtetërore ndjekur nga paligjshmëritë procedurale dhe inefficencat në realizimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe shkëlqet në zbatimin e legjislacionit fiskal.

A. Përmbledhëse e shkeljeve me pasojë dëm ekonomik në Buxhetin e Shtetit në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve

Tabela nr. 1

I.	Dëm ekonomik në të ardhura	000/lekë
	Nga Shkeljet në zbatimin e Legjislacionit Tatimor	1,038,069
	Nga Shkeljet në zbatimin e Kodit Doganor	453,211
	Nga keqadministrimi i pronës shtetërore të dhënë me qera, marrëveshjet hidrokarbure dhe kontratat koncensionare	36,785
	Të tjera	183,934
	Totali i Dëmit ekonomik në të ardhura	1,711,999
II.	Dëm Ekonomik në shpenzime	
	Në Shpenzimet për Paga, Sigurime dhe Shpërblime	94,179
	Në Shpenzimet Operative	16,130

Në Shpenzimet për Investime	336,009
Të tjera	20,581
Totali i Dëmit ekonomik në shpenzime	466,899
Totali i dëmit ekonomik (I+II) = 2,178,898 mijë lekë ose 17,5 milionë euro	

B. Të ardhura apo shpenzime të realizuara në kushtet e parregullsive në zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi dhe në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve për periudhën janar – qershor 2020.

Tabela nr.2

I. Efekte Negative në të Ardhurat e Buxhetit		000/lekë
1	Nga Shkeljet në Zbatimin e Legjislacionit Tatimor	922,167
2	Nga keqadministrimi i pronës shtetërore të dhënë me qera, marrëveshjet hidrokarbure dhe kontratat koncensionare	54,272
3	Të Tjera	73,632
4	Urbanistika	8,128
Totali		1,058,199

II. Efekte Negative për Shpenzimet e Buxhetit		000/lekë
1	Në Shpenzimet për Paga, Sigurime dhe Shpërblime	39,408
2	Në Shpenzimet Operative	47,736
3	Në Shpenzimet për Investime	882,095
4	Të tjera	249,050
Totali		1,218,289
Totali i efekteve negative në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit është 2,276,488 mijë lekë ose 18,3 milionë euro.		



Institucionet ku janë ushtruar misionet e auditimit


Auditimet janë kryer në 34 subjekte. Auditimet janë shtrirë në institucione qendrore dhe njësi të varësisë për të patur një mbulim të kënaqshëm dhe për të garantuar një sistem menaxhimi financiar dhe kontrolli sa më efektiv. Këtu përfshihen ministritë dhe agjencitë (drejtori qendrore dhe rajonale) në varësi të tyre, organet e sistemit fiskal, shoqëritë aksionere me kapital shtetëror, në të cilën shteti ka mbi 50% të aksioneve, njësi të vetëqeverisjes vendore (qarqe, bashki, komuna) si dhe projekte me financim të huaj, duke mbuluar të gjithë ciklin e veprimtarisë së tyre (të ardhurat dhe shpenzimet).

Tabela nr.3 Institucionet ku janë ushtruar misionet e auditimit

Auditimet e KLSH-së janë ushtruar në këto institucione:	Nr
Institucione të qeverisjes qendrore	7
Institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	13
Institucione të tjera financiare, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe institucionet vartëse financiare	2

Shoqëritë publike dhe projektet me financim të huaj	4
Institucionet e administrimit të aseteve dhe mbrojtjes së mjedisit	5
Institucionet në të cilat janë kryer auditimet IT	3
TOTALI I SUBJEKTEVE	34

Grafik nr.1 Subjektet e audituara në periudhën Janar – Qershor 2020



Burimi KLSH

Trajtimi i Letrave të qytetarëve

Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë periudhës Janar – Qershor 2020 ka vijuar të trajtojë me korrektesë dhe profesionalizëm letrat dhe ankesat e qytetarëve, të cilët në çdo rast kanë marrë përgjigje, edhe kur çështja e ngritur prej tyre ka qenë jashtë kompetencave të institucionit, duke i orientuar qytetarët, nëpërmjet përgjigjeve zyrtare se cilit institucion duhet ti drejtohen për të marrë përgjigje për shqetësimet e tyre.

Përgjatë kësaj periudhe KLSH ka trajtuar 126 letra dhe ankesa, nga të cilat 38 jashtë kompetencës dhe juridiksionit të institucionit. Nga 88 ankesa në kompetencë të KLSH, 71 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigje, ndërsa 17 janë në proces verifikimi.


Trajtimi i kërkesave për të drejtën e informimit

E drejta e informimit si një e drejtë kushtetuese dhe tanië parashikuar qartazi në një legjislacion të veçantë, është e drejtë elementare e çdo individi në një shoqëri demokratike. Që me miratimin e ligji të ri nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Kontrolli i Lartë i Shtetit ka pasur një numër në rritje kërkesash për informacion nga viti në vit, të ardhura nga individë, subjekte të ndryshme dhe OJF. Vetëm gjatë periudhës janar

– qershor 2020 janë trajtuar dhe u është përcjellë informacioni i kërkuar 12 kërkesave, të ardhura në adresën e koordinatorit të informimit të KLSH-së, të cilat përfshijnë 24 raporte auditimi.

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohen fushat kryesore të shqetësimit publik për çështje të qeverisjes në Shqipëri, nga të cilat 7% e ankesave të adresuara KLSH-së i takojnë administrimit financiar dhe fushës së prokurimit publik; 59% administrimit dhe kthimit të pronës dhe 25% fushave të tjera dhe 9% trajtojnë çështje të ndryshme.

Grafik nr. 2 Fushat kryesore të shqetësimit publik




Burimi KLSH

Rekomandimet sipas natyrës

KLSH, gjatë periudhës Janar – Qershor 2020, ka adresuar rekomandime për institucionet publike të audituara. Rekomandime për ndryshime apo përmirësime ligjore, organizative, masa administrative dhe disiplinore gjithsej janë 989, nga të cilat: 5 janë përmirësime ligjore, 236 masa rekomandime disiplinore dhe administrative dhe 748 rekomandime organizative.

Grafik nr.3 Masat e rekomanduara nga KLSH për periudhën Janar- Qershor 2020



Burimi KLSH

Kallëzimet Penale

KLSH nga auditimet e realizuara për periudhën Janar - Qershor 2020 ka përcjellë prokurorisë 10 kallëzime dhe indicie penale.

<i>Indicie për ndjekje penale</i>	5
<i>Vlerësim të dosjes nga Prokuroria</i>	2
<i>Kallëzim penal</i>	1
<i>Gjithsej</i>	<i>8 Indicie/Kallëzime penale</i>
<i>Persona të kallëzuar</i>	10

TREGUESIT E DËMIT EKONOMIK

Niveli i dëmit ekonomik dhe shpenzimeve joefektive apo me efekte negative (EEE) në buxhetin e shtetit në mënyrë të përmbledhur nga aktiviteti auditues përgjatë periudhës Janar – Qershor 2020 paraqiten si më poshtë:

A. Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej **2,178,898 mijë lekë ose 17,5 milionë euro**.

Treguesi (Indikatori) i dobisë së auditimit për periudhën Janar – Qershor është 12.4.

B. Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej **2,276,488 mijë lekë**, afërsisht nga e cila:

I. **1,058,199 mijë lekë** në fushën e të ardhurave, afërsisht 8,5 milionë euro;

II. **1,218,289 mijë lekë** afërsisht 9,8 milionë euro, në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve si dhe shkelje të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve, keqmenaxhimin e fondeve të programuara apo mugesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor.

Në total janë konstatuar shkelje në shumën **4,455,386 mijë lekë** ose afërsisht **35,8 milionë euro**.

**Kursi i këmbimit të lekut/euro është kursi i Bankës së Shqipërisë i datës 30.06.2020, 1 euro= 124.3 lekë.*

Këto shkelje financiare përgjithësisht i përkasin veprimtarisë ekonomiko-financiare për periudhën kohore 2018-2019 përcaktuar për çdo subjekt të audituar në programet e auditimit.

Treguesi i Dobishmërisë

Indikatori i dobisë së auditimit, i cili përbën një element thelbësor të Kuadrit të matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit, për periudhën Janar – Qershor 2020 rezultoi 12.4 çka do të thotë se për çdo 1 (një) lekë të shpenzuar për KLSH-në nga Buxhetit i Shtetit për periudhën Janar – Qershor 2020, janë zbuluar nga auditimet e kryera 12.4 lekë.

Treguesi i dobisë së auditimit llogaritet si raporti i dëmeve të zbuluara dhe të kërkuara për zhdëmtim nga KLSH në vlerën 2,178,898 lekë (17,5 milionë euro) me shpenzimet buxhetore faktike të KLSH-së në vlerën 175,028,241 lekë.

II. SHKELJET ME DËM EKONOMIK


KLSH ka zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare me pasojë dëm ekonomik në të ardhura dhe shpenzime, në shumën totale prej 2,178,898 mijë lekë, nga e cila ka rekomanduar për shpërblim dëmi shumën 2,160,604 mijë lekë.

Tabela nr.4

I	Dëmi ekonomik sipas fushave	000/Lekë
1	NGA SHKELJET NË ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT TATIMOR	1,038,069
2	NGA SHKELJET NË ZBATIMIN E KODIT DOGANOR	453,211
3	NGA KEQADMINISTRIMI I PRONËS SHTETËRORE TË DHËNË ME QERA, MARRËVESHJET HIDROKARBURE DHE KONTRATA KONCESIONE	36,785
4	TË TJERA	204,515
5	NË SHPENZIMET PËR PAGA, SIGURIME DHE SHPËRBLIME	94,179
6	NË SHPENZIMET OPERATIVE	16,130
7	NË PROKURIME PUBLIKE	336,009
	TOTALI I DËMEVE PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2020	2,178,898


Burimi KLSH

Grafik nr.4 Dëmi ekonomik sipas fushave në mijë lekë



Burimi KLSH

Grafik nr.5 Dëmi ekonomik sipas fushave në milionë lekë



Burimi KLSH

Parregullsitë dhe shkeljet financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik, janë pasqyruar në mënyrë më të detajuar në formularin nr. 2, bashkëlidhur këtij Buletini Statistikor.

DËMI EKONOMIK


II.a) Në fushën e të ardhurave

Tabela nr.5 Dëmi ekonomik në fushën e të ardhurave

Dëm Ekonomik	000/lekë
Në fushën e tatim taksave	1,038,069
Në fushën e doganave	453,211
Në fushën e shitjes, blerjes dhe dhënies me qira të pasurisë shtetërore, marrëveshjeve hidrokarbure dhe kontratave koncesionare	36,785
Të tjera	183,934
Totali	1,711,999

Burimi KLSH

Grafik nr. 6 Dëmi ekonomik në të ardhura (në mijë lekë) për periudhën Janar-Qershor 2020



Burimi KLSH

2.1 Në sektorin e Tatim – Taksave, në vlerën e përgjithshme prej 1,038,069 mijë lekë, konstatuar në institucionet:

Bashkia Rrogozhinë, në vlerën 190,021 mijë lekë, si pasojë e moszbatimit të procedurave për regjistrimin në kontabilitet të bizneseve debitore për periudhën para konsolidimit territorial, për taksat dhe tarifën e familjarëve, si dhe vlera nga asetet e dhëna me qira, nga të cilat:

- Vlera 26,631 mijë lekë është vlera e debisë për bizneset (detyrim+kamatë), nga e cila nuk është kontabilizuar detyrimi për vitin 2019;
- Vlera 23,891 mijë lekë është vlera debisë e pa kontabilizuar për 314 subjekte që kanë ushtruar aktivitet në periudhën 2011-2016.
- Vlera 99,599 mijë lekë është vlera e debisë e pa kontabilizuar për taksën e tokës;
- Vlera 38,929 mijë lekë, janë detyrime të pa paguara nga familjarët për taksën e tokës/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit;
- Vlera 971 mijë lekë, janë detyrime të papaguara për asetet e dhëna me qira.

Bashkia Finiq, në vlerën 10,800 mijë lekë, si pasojë e mos llogaritjes sipas ligjit të tarifës për pajisjen me leje tregtimi të karburantit për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante.

Bashkia Malësi e Madhe, në vlerën 3,520 mijë lekë, si pasojë e mos ndjekjes së rrugës ligjore për arkëtimin e penaliteteve të aplikuara për ndërtimet pa leje, masa të marra nga inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV). Gjithashtu këto gjoha, nuk janë kontabilizuar në librat e llogarive dhe kontabilitet si detyrime, pasi nga IMTV nuk janë përcjellë për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Rajonale – Agjencia Shtetërore e Kadastrës Sarandë, në vlerën 811,056 mijë lekë, si pasojë e mungesës së vërtetimeve mbi llogaritjen dhe pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 2312 objekte, për të cilat ka proceduar me vendim kualifikimi pa marrë konfirmimin mbi pagesën e saj.

Drejtoria Rajonale – Agjencia Shtetërore e Kadastrës Mirditë, në vlerën 14,915 mijë lekë, si pasojë e mos shlyerjes së detyrimeve financiare që rrjedhin nga miratimi i lejes së ndërtimit, lidhur me shlyrjen e detyrimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Drejtoria Rajonale – Agjencia Shtetërore e Kadastrës Mallakastër, në vlerën 7,648 mijë lekë, si pasojë e mos arkëtimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë, e cila është e pa likuiduar dhe vlera e parcelës ndërtimore në pritje të VKM për 244 objekte.

Drejtoria Rajonale – Agjencia Shtetërore e Kadastrës Përmet, në vlerën 109 mijë lekë, si pasojë e mos arkëtimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

2.2 Në sektorin e Doganave, në vlerën e përgjithshme prej 453,211 mijë lekë, konstatuar në institucionet:

Dega e Doganës Durrës, në vlerën 453,211 mijë lekë, nga të cilat:

- Vlera 169,645 mijë lekë, si pasojë e mos shqyrtimit të thelluar të vlerës doganore sipas indikatorëve të përcaktuar, me qëllim standartizimin dhe unifikimin e procedurave të shqyrtimit të vlerës së mallit për të evituar arbitraritetin, abuzivitetin dhe pabarazinë;
- Vlera 116,050 mijë lekë, si pasojë e konstatimit të diferencave progresive dhe 3-mujore të artikujve të importuar dhe të depozituar në Regjimin e Magazinave të Lira të "karburanteve", për subjektet të cilët kanë operuar në sektorin Porto Romano, ku për gjithë vitin ushtrimor rezulton në total 655688 litra lëndë djegëse, të cilave nuk u është dhënë destinacion doganor;
- Vlera 111,219 mijë lekë, si pasojë e mos respektimit të afateve të qëndrimit të mallrave në regjimin e lejimit të përkohshëm dhe mallrave të importuara, të cilave nuk i'u është dhënë destinacion doganor nga subjektet përfitues të RLP, për të cilat nga sektori i regjimeve nuk është mbajtur procesverbal konstatimi për shkeljet e konstatuara;
- Vlera 28,119 mijë lekë, si pasojë e tejkalimit të afatit 30 ditor për mbylljen e regjimeve; shkelje të kufirit të rieksporit; importe të produkteve parësore të papërfshira në autorizim; dokumenti i mbylljes së regjimit ekonomik (mod.3) nuk rezulton të jetë miratuar nga kryetari i degës së doganës; grupim mallrash në kodin tarifor me nivel të taksës doganore më të ulët, si dhe diferenca materiale në produktet kompensuese;
- Vlera 15,327 mijë lekë, si pasojë e vendimeve administrative për shkeljet në fushën doganore të nxjerra jo në përputhje me kërkesat e nenit 261 të Ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;

- Vlera 12,500 mijë lekë, rezultojnë veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 126.1/a të Kodit Doganor, të cilat u evidentuan pas shqyrtimit të dokumentacionit të praktikave doganore të operatorëve që kanë operuar nën mbikqyrjen doganore në regjimin e tranzitit (T1), ku nuk është respektuar afati i caktuar kohor për mbërritje në doganën e destinacionit;
- Vlera 350 mijë lekë, si pasojë e mos kryerjes së kalibrimeve për të gjitha depozitat e silloset me kapacitet mbajtës mbi 10 hektolitra si dhe mos disponimit të kalimatësave në hyrje dhe dalje të produktit në depozita si dhe në pikën e shitjes.

2.3 Në fushën e shitjes, blerjes dhe dhënies me qira të pasurisë shtetërore, marrëveshjeve hidrokarbure dhe kontratave koncensionare në shumën e përgjithshme prej 36,785 mijë lekë.

Administrimi i pronës publike është një koncept mjaft i gjerë. Në mënyrë të përmbledhur sjellim gjetjet më të rëndësishme lidhur me administrimin e pronës duke qënë se në këtë grup kemi dhe dëmet dhe ineficencat më të mëdha të strukturave shtetërore.

Bashkia Ura Vajgurore, në vlerën 36,652 mijë lekë, si pasojë e mos lidhjes së kontratave të qirave për shfrytëzimin e 35 ha sipërfaqe pyjore/kullosore për 17 subjekte, kontrata e qerasë është lidhur për sipërfaqen 16.2 ha. Për këto sipërfaqe nga Sektori i Pyjeve dhe Mbrojtjes Mjedisit nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor.

Porti Detar Vlorë SHA, në vlerën 133 mijë lekë, si pasojë e mos arkëtimit të shumës për vendosjen në ambientet e terminalit të ri të 2 tabelave reklame nga subjekti privat, lidhur me këtë rast disponohet një Kontratë Sponsorizimi e lidhur midis palëve.

2.4 Në fushën Të Tjera, në shumën e përgjithshme prej 183,934 mijë lekë.

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, në vlerën 151 mijë lekë, si pasojë e mos vlerësimit për aktivet e identifikuar si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit të vitit 2017 dhe të asgjësuar/tjetërsuar në vitin 2018, si dhe nuk është hartuar procesverbal vlerësimi.

Drejtoria Rajonale – Agjencia Shtetërore e Kadastrës Sarandë, në vlerën 158,028 mijë lekë, si pasojë e mos ndjekjes së të gjitha procedurave për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-së për 2035 dosje të objekteve informale të pajisur me

Leje legalizimi të objektit, për të mundësuar brenda afateve ligjore likuidimin e vleftës përkatëse të parcelave ndërtimore.

Drejtoria Rajonale – Agjencia Shtetërore e Kadastrës Mallakastër, në vlerën 15,536 mijë lekë, si pasojë e mos likuidimit të vlerës së parcelës ndërtimore dhe mos marrjes së masave për ndjekjen e ecurisë së procesit për daljen e VKM-së për kalimin e pronësisë dhe shpronësimin e ish-pronarëve përkatës.

Drejtoria Rajonale – Agjencia Shtetërore e Kadastrës Mirditë, në vlerën 8,506 mijë lekë, si pasojë e mos likuidimit të vlerës së parcelës ndërtimore.

Drejtoria Rajonale – Agjencia Shtetërore e Kadastrës Përmet, në vlerën 1,713 mijë lekë, si pasojë mos llogaritjes dhe arkëtimit të kamatë vonesës për regjistrimin me vonesë të aktit administrativ.


II.b) Në fushën e shpenzimeve

Tabela nr.6 Përmbledhja e shkeljeve me pasojë dëm ekonomik në fushën e shpenzimeve

Dëm Ekonomik	000/lekë
Në Shpenzimet për Paga, Sigurime dhe Shpërblime	94,179
Në Shpenzimet Operative	16,130
Në Shpenzimet për Investime	336,009
Të tjera	20,581
Totali	466,899

Burimi KLSH

Grafik nr. 7 Dëmi ekonomik në shpenzime (në mijë lekë) për periudhën Janar-Qershor 2020



Burimi KLSH

2.1 Në fushën e pagave, shpërblimeve dhe sigurimeve shoqërore, në vlerën e përgjithshme prej 94,179 mijë lekë, konstatuar në institucionet:

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, në vlerën 515 mijë lekë, si pasojë e pagesave me pagë grupi, e cila është jo në përputhje me nivelin e diplomës, konstatuar për 3 (tre) punonjës.

Bashkia Malësi e Madhe, në vlerën 564 mijë lekë, si pasojë e pagave të paguara padrejtësisht për 4 (katër) punonjës për periudhën e viteve 2018-2019-2020 mbi strukturën e pagave, ku janë emëruar punonjës jo me arsimin e duhur.

Ujësjiellës Kanalizimeve Kavajë SHA, në vlerën 92,984 mijë lekë, të ardhur si pasojë e punësimeve mbi strukturë, pra tejkalim të strukturës së shoqërisë nga ajo e miratuar me vendim të Këshillit Administrativ deri në 150 punonjës mbi strukturë (gjatë muajve muajve; tetor, nëntor, dhjetor, 2019 numri total i punonjësve ka arritur mbi 315 punonjës nga 152 punonjës që ka në strukturë e miratuar).

Porti Detar Shëngjin SHA, në vlerën 116 mijë lekë, si pasojë e pëfitimit padrejtësisht të shpërblimit nga 1 (një) nga anëtarët e Këshillit, i cili ka munguar më shumë se 3 mbledhje radhazi.


2.2 Dëmi ekonomik¹ i rezultuar në fushën e prokurimit të nevojave për mallra/shërbime/investime publike, kap vlerën e përgjithshme 336,009 mijë lekë. Dëmi është konstatuar si në fazën e zhvillimit të procedurave të prokurimit, ashtu edhe në fazën e zbatimit të kontratave dhe dorëzimit të punimeve

Problematikat e konstatuara nga auditimet lidhen jo vetëm me planifikim jo të drejtë të nevojave por edhe një proces të realizuar jo në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Mangësitë i referohen implementimit jo të saktë të kërkesave dhe detyrimeve ligjore nga entet publike që prokurojnë fondet përmes sistemit të prokurimit publik, fakt që lidhet edhe me kapacitetet njerëzore jo gjithmonë profesionale, që përfshihen në realizimin e këtij procesi. Dëmi ekonomik në fushën e prokurimeve publike konstatohet si shkelje në: përgatitjen e dokumentacionit të tenderit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vlerësimit; llogaritjen e vlerës së kontratës; respektimin e kufijve monetar/ përzgjedhjen e procedurës së prokurimit publik; paraqitjen dhe pranimin e ofertave; hapjen dhe shqyrtimin e ofertave të paraqitura në konkurim; në njoftimin

¹ Përmirësimi ligjor që propozohet nga KLSH është fokusuar në vlefshmërinë e procedurave të prokurimit në jo më pak se dy operatorë ekonomik pjesëmarrës që plotësojnë kriteret e kualifikimit nisur nga numri i lartë i procedurave të prokurimit me një pjesëmarrës dhe fitues njëkohësisht.

e fituesit, në procedurat e prokurimit me një ofertues, në lidhjen e kontratave dhe marrëdhëniet me nënkontraktorët, arkivimin e dosjeve për tenderat e zhvilluar; zbatimin e kontratave nga kontraktorët në përputhje me kushtet e përgjithshme etj. Në total, për periudhën janar - qershor 2020, vetëm nga auditimi i procedurave të prokurimit ka një dëm ekonomik në shumën 336,009 mijë lekë nga të cilat vlera 270,649 mijë lekë në procedurë prokurimi dhe vlera 65,360 mijë lekë gjatë zbatimit të kontratave dhe dorëzimit të punimeve.


Grafik nr.8: Dëmi ekonomik në fushën e prokurimeve në %



Burimi KLSH

Duke ju referuar grafikut nr.9 konstatohet se shkeljet dhe problematikat në lidhje me procedurat e prokurimit më të mëdha vërehen në auditimin e ushtruar në Agjencinë e Blerjeve të Përqëndruara (ABP) me vlerë 209,677 mijë lekë. Rezultojnë problematika në hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, me mos përgatitjen dhe hartimin e një pakete për unifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për një pjesë të konsiderueshme të fondeve buxhetore nuk është arritur efienca dhe efektiviteti.

Grafiku nr. 9 Dëmi ekonomik i konstatuar në fazën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në Agjencinë e Blerjeve të Përqëndruara



Burimi KLSH

2.2.1 Shkelje në realizimin e procedurave të prokurimit

Shkeljet në procedurat e prokurimit vetëm në 9 subjekte, kanë sjellë një dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në masën 270,649 mijë lekë. Shkeljet kanë rezultuar në plotësimin e kriterëve të kualifikimit, në skualifikimet e ofertuesve, në hapjen e shqyrtimin e ofertave, në ofertat anomalisht të ulta dhe zhvillohen procedura prokurimi me një pjesëmarrës dhe fitues njëkohësisht.

Tabela nr. 8 Dëmi ekonomik i konstatuar në realizimin e procedurave të prokurimit

Subjektet e audituara	Vlera (në mijë lekë)
Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara	209,677
Bashkia Finiq	41,917
Bashkia Divjakë	13,222
Bashkia Ura Vajgurore	2,107
Shërbimi Kombëtar i Punësimit	1,396
Porti Detar Shëngjin SHA	813
Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	801
Instituti i Monumenteve të Kulturës	622
Ujësjetllës Kanalizime Kavajë SHA	94
Totali (në mijë lekë)	270,649

Burimi KLSH

2.2.2 Shkelje në zbatimin e punimeve, në institucionet si më poshtë:

Shkeljet në zbatimin e kontratave për 8 subjekte, kanë sjellë dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në masën 65,360 mijë lekë. Shkeljet e këtij grupimi fillojnë me problemet në lidhjen e kontratave, aktet e marrjes në dorëzim, në mungesa apo problematika në kryerjen e punimeve të ndërtimit, inventarizim dosjesh etj.

Tabela nr.9 Dëmi ekonomik i konstatuar në zbatimin e punimeve

Subjektet e audituara	Vlera (në mijë lekë)
Shërbimi Kombëtar i Punësimit	29,844
Bashkia Finiq	21,647
Porti Detar Vlorë SHA	3,774
Bashkia Ura Vajgurore	3,403
Bashkia Skrapar	3,118
Bashkia Divjakë	2,511
Bashkia Malësi e Madhe	988
Instituti i Monumenteve të Kulturës	75
Totali (në mijë lekë)	65,360

Burimi KLSH

2.3 Në fushën e shpenzimeve operative, në vlerën e përgjithshme prej 16,130 mijë lekë, konstatuar në institucionet:

Tabela nr. 10

Subjektet e audituara	Vlera (në mijë lekë)
Ujësjetës Kanalizime Kavajë SHA	8,183
Bashkia Skrapar	2,178
Shërbimi Kombëtar i Punësimit	2,041
Rezidenca Studentore nr.2 SHA Tiranë	1,194
Bashkia Finiq	1,728
Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	778
Porti Detar Vlorë SHA	28
Totali (në mijë lekë)	16,130

Burimi KLSH

2.4 Në fushën Të Tjera, në shumën e përgjithshme prej 20,581 mijë lekë

Bashkia Cërrik, në vlerën 9,789 mijë lekë, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera ndaj operatorëve ekonomik.

Bashkia Malësi e Madhe, në vlerën 9,500 mijë lekë, si pasojë e mos pajisjes me Autorizim/Licenca të subjekteve që kryejnë tregti me pakicë të karburantëve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave librikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.


Bashkia Finiq, në vlerën 1,292 mijë lekë, si pasojë e mos mungesës së dokumentacionit (hyrje/dalje dhe gjëndje) për konsumimin e karburantit në vitet 2017-2019.

III. SHKELJE TË DISIPLINËS FINANCIARE ME NDIKIM NEGATIV NË PERFORMANCËN E ADMINISTRIMIT TË TË ARDHURAVE DHE NË PËRDORIMIN E FONDEVE PUBLIKE PËR SUBJEKTET E AUDITUARA

Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë periudhës janar - qershor 2020, ka evidentuar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave dhe në përdorimin e fondeve publike në vlerën totale 2,113,514 mijë lekë nga të cilat: 946,334 mijë lekë në fushën e të ardhurave dhe 1,167,180 mijë lekë në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve, si dhe shkelje të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve, keqmenaxhimin e fondeve të programuara apo mugesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor.


Në grafikun e mëposhtëm ilustrohen shkeljet e disiplinës financiare në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Grafik nr.10 Shkelje të disiplinës financiare në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve në %



Burimi KLSH

Grafik nr.11 Shkelje të disiplinës financiare në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve (në milionë lekë)



Burimi KLSH

Shkeljet e disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, janë pasqyruar në mënyrë më të detajuar në formularin nr. 3, bashkëlidhur këtij Buletini Statistikor.

III.1 Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në administrimin e të ardhurave

Shkelje e të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave për subjektet e audituara, kapin vlerën 946,334 mijë lekë.

Grafik nr.12: Shkelje të disiplinës financiare në fushën e të ardhurave (mijë lekë)



Burimi KLSH

Efektet negative të lidhura me administrimin e sistemit tatimor & doganor, nga qiratë & privatizimit, koncesionet, Urbanistikës dhe në fushën të tjera.

Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, në vlerën 3,711 mijë lekë, si pasojë e kamat vonesave për likuidimin e qerasë në kundërshtim me nenin 4, pika 1 dhe 3 të Kontratave tip me subjekte vendase.

Bashkia Ura Vajguore, në vlerën 246,729 mijë lekë, nga të cilat:

- 223,114 mijë lekë, si pasojë e mos pagesës së taksës së tokës me tarifat përkatëse, 7531 familje në shumën 166,711 mijë lekë, taksa lokale me tarifat përkatëse, 909 familje në shumën 9,010 mijë lekë, si dhe 210 familje për qiranë e tokës bujqësore në vlerën 12,228 mijë lekë të cilët rezultojnë debitorë me datë 31.12.2019. Për vitin 2019, nuk kanë paguar taksë ndërtese, pastrimi, ndriçimi e gjelbërimi 5439 familje në shumën 13,001 mijë lekë, të cilët rezultojnë debitorë me datë 31.12.2019. Nga subjekte të biznesit të vogël dhe të madh për të cilat janë planifikuar të ardhura për taksa e tarifa vendore pavarësisht punës së bërë niveli i arkëtimit është shumë i ulët, kanë mbetur pa u arkëtuar 13,542 mijë lekë. Gjithashtu nuk janë arkëtuar gjobat e vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes Territorit Vendor për periudhën deri 31.12.2019 në vlerën 2,020 mijë lekë. Gjatë auditimit të taksave/ tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, janë konstatuar mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti duke mos u paguar detyrimet për pajisje me licence tregtimi në përputhje me bazën ligjore në vlerën 6,600 mijë lekë.

- Vlera 23,615 mijë lekë, si pasojë e mos arkëtimit të detyrimeve tatimore nga 95 subjekte të biznesit të vogël, 23 të biznesit të madh, të cilët nga të dhënat e zyrës së financës janë kontabilizuar.

Bashkia Rrogozhinë, në vlerën 221,658 mijë lekë, si pasojë e mos zbatimit të procedurave për regjistrimin në kontabilitet dhe mos marrjen e masave nga sektori i të ardhurave për arkëtimin e detyrimeve debitore (188 biznese të vogla dhe 34 biznese të mëdha), për periudhën para konsolidimit territorial, për taksat dhe tarifën e familjarëve, si dhe vlera nga asetet e dhëna me qira.

Bashkia Finiq, në vlerën 161,232 mijë lekë, nga të cilat:

- Vlera 131,649 mijë lekë, si pasojë e mos arkëtimit të detyrimeve të prapambetura (borxhi tatimor) për 204 subjekte fizik/juridik për taksat e pasurisë së tokës, ndërtesës, hapësirave publike, tarifave vendore dhe 4539 abonentët familjarë për taksën e pasurisë dhe tarifën vendore;
- Vlera 29,583 mijë lekë, si pasojë e lidhjes së kontratës në kundërshtim me bazën ligjore për dhënien me qira për 30 vjet të sipërfaqeve të fondit pyjor e kullosor, kur së pari toka e dhënë me qira nuk është kategorizuar në zërin " tokë me bimësi pyjore djerr" dhe kur qëllimi i përdorimit është për mbarësimin e faunës dhe florës.

Bashkia Malësi e Madhe, në vlerën 141,083 mijë lekë, nga të cilat:

- Vlera 113,743 mijë lekë, si pasojë e mosarkëtimit të detyrimeve të prapambetura (borxhi tatimor) për 11420 subjekte. Në fund të periudhës 31.12.2019, gjëndja e debitorëve për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë është:
 - a) 211 subjekte fizik/juridik me vlerë 26,652 mijë lekë për taksat pasurisë, tokës, ndërtesës, hapësirave publike dhe tarifave vendore.
 - b) 11209 abonentët familjarë me vlerë 87,091 mijë lekë, për taksën e pasurisë dhe tarifën vendore, nga e cila: taksa tokë bujqësore në shumën 3,653 mijë lekë, taksë ndërtesë në vlerën 16,763 mijë lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 64,505 mijë lekë. Vlera e debitorëve abonentëve familjarë është 76.5 % e vlerës së gjithë borxhit fiskal.
- Vlera 13,287 mijë lekë, si pasojë e mos zbatimit të kushteve të kontratave lidhur midis bashkisë Malësi e Madhe (ish Komuna

Shkrel) me subjektin "M.S" për dhënien me qira të sipërfaqes prej 15 ha për një kohë rreth 30 vite.

- Vlera 8,128 mijë lekë, si pasojë e mos arkëtimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë
- Vlera 5,925 mijë lekë, si pasojë e mosmenaxhimit për lirimin ose lidhjen e kontratave të qirasë së objekteve në pronësi të bashkisë të uzurpuar nga të tretë.

Bashkia Skrapar në vlerën 89,263 mijë lekë, si pasojë e mos marrjes së masave nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në fund të vitit 2019 janë krijuar debitorë të subjekteve fizik/juridik dhe debitorë familjarë për taksat dhe tarifa vendore dhe gjithashtu debitorë të konstatuar nga kontrole të ndryshme para datës 31.12.2016 të bashkisë Çorovodë dhe 8 (tetë) Njësitë Administrative.

Prefekti i Qarkut Tiranë, në vlerën 67,707 mijë lekë, veprim në papajtueshmëri me Ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për tokën" të ndryshuar. Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë për 38 raste nuk kanë kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative nga mbajtësi i parë i titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore të përfitur në kundërshtim me ligjin.

Bashkia Divjakë, në vlerën 12,325 mijë lekë, nga të cilët:

- Vlera 6,367 mijë lekë, si pasojë mos arkëtimit të qirasë nga subjekte të ndryshme (debitorë) për dhënien e aseteve në pronësi të bashkisë.
- Vlera 5,958 mijë lekë, si pasojë e mos zbatimit të VKM Nr.860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, si dhe ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, pika 3 e nenit 27 - Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen. Rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukture.

Porti Detar Shëngjin SHA, në vlerën 2,431 mijë lekë, si pasojë e mospërputhjeve midis emërimit të pozicionit të punës të shënuar në kontratën e punës dhe atij të shënuar në listëprezencë, listëpagesë dhe në sistemin tatimor dhe gjithashtu dublim të pozicioneve të punës.

Porti Detar Vlorë SHA, në vlerën 195 mijë lekë, si pasojë e favorizimit padrejtesisht subjektin qiramarrës nëpërmjet lidhjes së kontratës me mangësi në dokumentacion, duke lidhur kontratë pa ngurtësuar më


parë sigurimin e kontratës si dhe duke lejuar lidhjen e një kontrate të re pa respektuar afatin për ndërprerje të kontratës së parë.

III.2 Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e përdorimit të fondeve publike nga subjekteve të audituara.

Shkelje e të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shpenzimin e fondeve në dispozicion, kapin vlerën 1,167,180 mijë lekë.

Shkeljet e disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shpenzimin e fondeve kanë rezultuar në fushën e pagave dhe shpërblimeve, në fushën e keqmenaxhimit të fondeve të programuara për shpenzime operative, në fushën e prokurimit të fondeve publike dhe realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor.

Grafik nr.13: Shkelje të disiplinës financiare në fushën e shpenzimeve



Burimi KLSH

Efekte financiare në fushën e pagave dhe shpërblimeve

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, në vlerën 24,978 mijë lekë, si pasojë e parregullsive në 12 procedua rekrutimi, që përfshin të gjitha nivelet menaxheriale duke shkaktuar shpenzim në kushtet e paligjshmërisë për vitet 2016-2019.

Porti Detar Shëngjin SHA, në vlerën 5,092 mijë lekë, si pasojë e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për 23 punonjës të shoqërisë. Largimet e punonjësve, si dhe mos ndjekjen e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nga ish titullari si dhe nga Këshilli Mbikëqyrës.

Porti Detar Vlorë SHA, në vlerën 5,078 mijë lekë, si pasojë e mos ndjekjes së procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve

të punës me ish punonjësit. Shoqëria është paditur nga 11 persona, nga të cilët 4 çështje janë në proces gjykimi dhe 7 procedura kanë përfunduar duke e detyruar Portin Vlorë të paguajë dëmshpërblimin dhe shpenzimet gjyqësore.

Rezidenca Studentore nr.2 Tiranë SHA, në vlerën 4,260 mijë lekë, si pasojë e ndryshimeve të shpeshta të strukturës duke suprimuar vëndet e punës për 24 punonjës, miratuar me Vendimin nr.63, datë 17.11.2017 dhe Nr.76, datë 27.04.2018 të Këshillit Mbikëqyrës. Nga punonjësit e larguar nga puna rezultoi se janë ngritur padi në organet gjyqësore për largim të padrejtë nga puna dhe nga auditimi i dokumentacionit për shpenzime për vendime gjyqësore dhe shpenzime përmbartimore.

[Efekte financiare nga keqmenaxhimi i fondeve të programuara për shpenzime operative, lidhur me shkeljet ligjore me marrjen e angazhimeve deri në mungesën e kontrolleve për të mbajtur kostot buxhetore në nivelin e programuar, apo shkelje të tjera të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve.](#)

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, në vlerën 9,046 mijë lekë, si pasojë e shpenzimeve për udhëtime dhe dieta në kushtet e paligjshmërisë për vitin 2018-2019. Në 130 raste ose 95% të rasteve, janë kryer shpenzime për udhëtime e dieta, të pambështetur me dokumentacionin vërtetues për kryerjen për kryerjen e detyrës.

Instituti i Monumenteve të Kulturës, në vlerën 7,011 mijë lekë, nga të cilat:

- Vlera 6,651 mijë lekë, si pasojë e pagesave për vendime gjyqësore për largim të padrejtë nga puna, të cilat thuajse në të gjitha rastet janë fituar nga punonjësit.
- Vlera 360 mijë lekë, janë paguar shpenzime për mirëmbajtje të sistemeve informatikë WEB GIS, sistem i cili përdoret për inventarizim dhe paraqitjen në hartë të monumenteve të kulturës.

Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, në vlerën 760 mijë lekë, si pasojë e mos menaxhimit të fondeve për shpenzimin e "Udhëtimit turistik" jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Bashkia Malësi e Madhe, në vlerën 12,005 mijë lekë, si pasojë e pagesave të kryera në artikullin 602, financime në formë Sponsorizime ekipin e futbollit, i cili ka statusin "Shoqatë", duke financuar për dieta, trajtim ushqimorë, shërbim transporti, nga të cilat në vitin 2018 në shumën 4,566 mijë lekë dhe në vitin 2019 në shumën 7,438 mijë lekë.

Bashkia Skrapar, në vlerën 8,121 mijë lekë, si rezultat i mos likuidimit në kohë të detyrimeve për energjinë elektrike nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike për periudhën dy vjeçare 2010-2011, për 17 kontrata të energjisë elektrike për ndriçimin rrugor, në datën 29.06.2018 midis Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe OSHEE është nënshkruar akt-marrëveshje për shlyerjen me këste të detyrimit të konstatuar në vlerën 12,942,139 lekë, me vlerë të këstit mujor 171,257 lekë, nga e cila principal 84,950 lekë dhe 86,308 lekë kamat-vonesë. Për periudhën 18 mujore (korrik 2018-dhjetor 2019), vlera e kamatë vonesës së paguar është 1,553,544 lekë, e cila është shpenzim i kryer jo për mall, punë apo shërbim, por për mos përmbushje në kohë të detyrimeve nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

Agjencia për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore (AMVV), në vlerën 3,338 mijë lekë, janë kryer shpenzime për seminare, për veprimtari të ndryshme të organizuara për seminare, fonde të akorduara nga buxheti në artikullin 602/9009 "Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca e seminare për pritje përcjellje" pa ju nënshtruar procedurës së prokurimit publik në 9 raste për vitin 2017-2018.

Bashkia Finiq, në vlerën 1,233 mijë lekë, si pasojë e pagesave të kryera pa u miratuar me vendim nga Këshilli i Bashkisë për shpenzime transporti urban dhe shpenzime karburant gjithsej 7044 litra.

Porti Detar Vlorë SHA, në vlerën 813 mijë lekë, si pasojë e shpenzimeve (Në kartelat përkatëse të mjeteve, në të cilat regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to) që janë kryer për automjetet e shoqërisë, në të cilat nuk kanë evidentuar kilometrazhin në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra e vaj, karburant, riparime etj. Këto shpenzime nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre.

Efekte negative të lidhura me mungesa kontrolli nga strukturat shtetërore gjatë prokurimit të fondeve publike dhe realizim të procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor.

Nga auditimet e realizuar janë konstatuar problematika të cilat lidhen me mungesën e sistemeve të kontrollit nga strukturat përgjegjëse të prokurimeve, shoqëruar me paligjshmëri të proceseve të prokurimit të fondeve publike, duke ulur efektivitetin e qëllimit kryesor të ligjit për prokurimet publike, pra atë të sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar.

Po ti referohemi efekteve negative në fushën e prokurimeve të evidentuara në 34 auditime të realizuara përgjatë periudhës janar – qershor 2020, rezulton se 13 subjektet e mëposhtme zënë rreth 72% të vlerës së përdorimit jo me efektivitet të fondeve të prokuruar si dhe rreth 40 % të vlerës totale të evidentuar në shkeljet e disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shpenzimin e fondeve në dispozicion.

Në tabelën më poshtë kemi grupuar problematikat me një shtrirje dhe shpërndarje thuaj uniforme në strukturat e audituara.

Tabela nr.11

Subjektet me efekte negative në fushën e prokurimeve	Vlera në mijë lekë
Bashkia Ura Vajgurore	343,492
Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara (ABP)	210,052
Bashkia Finiq	138,142
Bashkia Malësi e Madhe	118,639
Ministria e Kulturës	45,700
Prefekti i Qarkut Tiranë	14,399
Ujësjetës Kanalizime Kavajë SHA	4,307
Bashkia Divjakë	2,123
Instituti i Monumenteve të Kulturës	1,394
Bashkia Skrapar	1,248
Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	1,205
Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik	480
Rezidenca Studentore nr.2 Tiranë SHA	914

Burimi KLSH

Problematikat janë konstatuar në institucionet:

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, në vlerën 1,205 mijë lekë, si pasojë e mos zbatimit të gjurmës së auditimit për procedurat e prokurimit me qëllim përdorimin me eficiencë, efektivitete dhe ekonomikitet të fondeve buxhetore.

Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara (ABP), në vlerën 210,052 mijë lekë, si pasojë e skualifikimit të operatorëve që kanë pasur ofertat ekonomike në vlerë më të ulët se vlera e ofertave të operatorëve të shpallur fitues. Skualifikimi i këtyre operatorëve është bërë për mos përmbushjen e disa kriterëve të veçanta të cilat mund të konsideroheshin si devijime të vogla sepse nuk janë thelbësorë dhe nuk ndikonin në realizimin me sukses të kontratave të mallrave dhe shërbimeve. Ky problem ka ndodhur për shkak të mungesës së një pakete për të unifikuar kriteret e veçanta të kualifikimit për çdo grup mallrash dhe shërbimesh (p.sh, për tonerët, shërbimi i katereingut, etj.).

Ministria e Kulturës, në vlerën 45,700 mijë lekë, për shkak se nuk është arritur konkurrenca minimale. Planifikimi i fondeve vetëm për realizimin e projekteve dhe jo për implementimin e tyre, e vendos MK-në përballë riskut potencial të keqmenaxhimit të fondeve buxhetore. Vlera e financuar vetëm për hartimin e projekteve për restaurimin, rikonstruksionin dhe rehabilitimin e hapësirave të Muzeut Historik Kombëtar dhe Muzeu Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve).

Instituti i Monumenteve të Kulturës, në vlerën 1,394 mijë lekë, si pasojë e trajtimit në mënyrë jo të barabartë operatorët ekonomik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për "*Restaurim Kisha "Shën Mërisë" Peshkëpi e Sipërme, Gjirokastër" 2018*, konstatohet se nga sistemi i vlerësimit të pikëve nga KVO, janë trajtuar në mënyrë të pabarabartë operatorët ekonomik.

Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, në vlerën 480 mijë lekë, si pasojë përdorimit të fondeve publike pa eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet. Sipas specifikimeve teknike të përcaktuara, qëllimi i punës është se operatori fitues duhet të eliminojë të gjitha defektet e shfaqura gjatë punës së ashensorëve dhe riparimin e tyre si dhe shërbimin e detyruar mujor dhe periodik. Mirëmbajtja e ashensorëve do të përmbajë shërbimin e detyruar mujor si dhe riparime e shërbime periodike.

Bashkia Ura Vajgurore, në vlerën 343,492 mijë lekë, nga të cilat:

- Vlera 342,867 mijë lekë, si pasojë e mos zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore të ligjit të prokurimit publik në 43 procedura prokurimi, ku operatorët ekonomik të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (AK). Kualifikimi i operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, por edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës
- Vlera 625 mijë lekë, rezulton neglizhencë nga Autoriteti Kontraktor në verifikimin e gjëndjes dhe marrjen e masave të nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimit me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në kontratën me objekt "*Rikualifikimi urban dhe krijimi i ambienteve të Rekreacionit në fshatin Donofrose*".

Bashkia Finiq, në vlerën 138,142 mijë, si pasojë e mos zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore të ligjit të prokurimit publik në 14

procedura prokurimi, ku operatorët ekonomik të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (AK). Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, procedurat duheshin anuluar për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet (3E).

Bashkia Malësi e Madhe, në vlerën 118,639 mijë lekë, si pasojë e mos zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore të ligjit të prokurimit publik në 4 procedura prokurimi, ku operatorët ekonomik të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (AK). Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, procedurat duhej anuluar për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publike.

Prefekti i Qarkut Tiranë, në vlerën 14,399 mijë lekë, nga të cilat:

- Vlera 12,208 mijë lekë, si pasojë e mos anulimit të procedurës për arsye se asnjë nga operatorët ekonomik pjesëmarrës nuk plotëson kriteret e vendosura në DST edhe pse janë evidentuar mangësi të konsideruara devijime të vogla në kriteret e kërkesave kualifikuese;
- Vlera 2,191 mijë lekë, si pasojë e marrjes në dorëzim të mjetit (dy mjete) e pa kërkuar, ndërkohë që AK ka bërë kërkesë për të prokuruar vetëm për 1 (një) automjet, megjithatë automjetet e kontraktuar janë marr në dorëzim nga komisioni, pa evidentuara në procesverbal në se, janë plotësuar kriteret e specifikimeve teknike që i përkasin kualifikimit me ato të vendosura në DST.

Bashkia Divjakë, në vlerën 2,123 mijë lekë, si pasojë e diferencave me ofertën e OE (operatorëve ekonomik) të shpallur fitues me ofertën e OE të skualifikuar. Veprimet dhe mosveprimet nuk përputhen me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi mbi prokurimet publike dhe kanë shkaktuar përdorim jo efektiv të fondeve në procedura prokurimi.

Bashkia Skrapar, në vlerën 1,248 mijë lekë, si pasojë e veprimeve e mos veprimeve të komisionit të vlerësimit të ofertave, Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe komisionit të marrjes në dorëzim të mallit, AK Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, ka blerë një mjet i cili nuk ka qenë objekt i procedurës së prokurimit (tenderit të zhvilluar) në datën 04.05.2017 me objekt " Blerje kamioni për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike.

Ujësjetës Kanalizime Kavajë SHA, në vlerën 4,307 mijë lekë, konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet. Në procedurat e prokurimit publik për vitin 2019, blerje me vlerë të vogël, u konstatua mungesa e plotësisht të kriterëve të

veçanta të vendosura në DST nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël.

Rezidenca studentore nr.2 Tiranë SHA, në vlerën 914 mijë lekë, si pasojë e mos administrimit të fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

Efekte financiare në fushën të tjera

Shërbimi Kombëtar i Punësimit, në vlerën 166,182 mijë lekë, si pasojë e mungesës së kontrollit të brendshëm dhe e monitorimit nga SHKP, mungesa e gjurmës së auditimit në mënyrë të vazhdueshme si dhe kreditimi i dyfishtë nëpërmjet faturave të blerjes së pargumentuar, sjell një përdorim të fondeve pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë.


Bashkia Cërrik, në vlerën 10,599 mijë lekë, si pasojë e vlerësimit dhe shpalljes fitues në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim në DT, duke mos anuluar procedurën e prokurimit.

Rezidenca Studentore nr.2 Tiranë SHA, në vlerën 72,269 mijë lekë, ka ardhur si pasojë jo vetëm e mos planifikimit të saktë të numrit të punonjësve por dhe mos sigurimit të plotësimit të kapaciteteve në dispozicion dhe mos marrjen e masave të duhura për përmirësimin e rezultatit financiar vjetor për të shpëtuar këtë shoqëri nga falimenti.

IV.AUDITIMET ME OPINION

Bazuar në planin vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën Janar-Qershor 2020, KLSH ka dhënë opinione për 30 misione auditimi, nga të cilat 4 janë opinione financiare, 15 opinione përputhshmërie dhe 11 janë opinione financiare dhe përputhshmërie.

Grafik nr.14 Opinione të audituesit në %



Burimi KLSH

IV.1 DHËNIE OPINIONI PËR AUDITIMET FINANCIARE

Për periudhën Janar – Qershor të vitit 2020, KLSH ka kryer 4 auditime financiare nga të cilat 2 janë auditime ku janë dhënë opinione të pakualifikuara në subjektet INSTAT, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë. Opinioni ka qenë i kualifikuar në 2 subjekte, Bashkia Rrogozhinë dhe Bashkia Roskovec.

Tabela nr. 12 Opinioni për auditimet financiare

Nr.	SUBJEKTI	OPINIONI I AUDITUESIT					
		I Pakualifikuar		Opinion i kualifikuar		Opinion i kundërt	Refuzim i opinionit
		Pa rezervë	Me rezervë	Pa rezervë	Me rezervë		
1	INSTAT	1					
2	Bashkia Rrogozhinë				1		
3	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë	1					
4	Bashkia Roskovec			1			

Burimi KLSH

IV.2 DHËNIE OPINIONI PËR AUDITIMET E PËRPUTHSHMËRISË

Bazuar në planin vjetor të auditimeve, për periudhën Janar – Qershor të vitit 2020, KLSH ka kryer 15 auditime përputhshmërie nga të cilat 7 janë auditime ku janë dhënë opinione të kualifikuar në subjektet: Instituti i Monumenteve të Kulturës, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, Drejtoria e Shërbimit Kombëtar i Punësimit, DVASHK Mirëditë, DVASHK Përmet, DVASHK Mallakastër. Në subjektet Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik dhe DVASHK Sarandë opinioni ka qenë i pakualifikuar, ndërsa në Bashkinë Skrapar, Rezidencën Studentore nr.2 Tiranë SHA, Porti Detar Vlorë SHA, Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA, grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin e një Opinioni të Kundërt.

Tabela nr. 13 Opinioni për auditimet e përputhshmërisë

Nr.	SUBJEKTI	OPINIONI I AUDITUESIT					
		I Pakualifikuar		Opinion i kualifikuar		Opinion i kundërt	Komente
		Pa rezervë	Me rezervë	Pa rezervë	Me rezervë		
1	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik	1					
2	Instituti i Monumenteve të Kulturës				1		
3	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore			1			
4	Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara			1			

5	Drejtoria e Shërbimit Kombëtar i Punësimit			1			
6	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore						Pa opinion
7	Bashkia Skrapar					1	
8	ZVRPP Mirditë			1			
9	ZVRPP Përmet			1			
10	DVASHK Sarandë		1				
11	ZVRPP Mallakastër				1		
12	Rezidenca Studentore nr. 2 Tiranë SHA					1	
13	Porti Detar Vlorë SHA					1	
14	Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA					1	
15	Porti Detar Shëngjin SHA						Pa opinion

Burimi KLSH

IV.3 DHËNIE OPINIONI MBI PASQYRAT FINANCIARE DHE OPINION MBI PËRPUTHSHMËRINË

KLSH, për periudhën Janar – Qershor të vitit 2020, ka kryer 10 auditime financiar dhe përputhshmërie, për të cilat janë dhënie opinione mbi pasqyrat financiare dhe opinione mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve të audituara.

Tabela nr. 14 Opinioni mbi pasqyrat financiare dhe opinion mbi përputhshmërinë

Nr	SUBJEKTI	OPINION MBI PASQYRAT FINANCIARE				OPINION MBI PËRPUTHSHMËRINË			
		I Pakualifikuar		Opinion i kualifikuar	Opinion i kundërt	I Pakualifikuar		Opinion i kualifikuar	Opinion i kundërt
		Pa rezervë	Me rezervë			Pa rezervë	Me rezervë		
1	Ministria e Kulturës	1				1			
2	Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	1						1	
3	Prefekti i Qarkut Tiranë		1				1		
4	Bashkia Finiq				1			1	
5	Bashkia Divjakë			1			1		
6	Bashkia Cërrik		1				1		
7	Bashkia Maliq		1				1		
8	Këshilli i Qarkut Gjirokastrë		1				1		
9	Bashkia Malësi e Madhe	1				1			
10	Bashkia Ura Vajgurore			1			1		

Burimi KLSH

V. Auditimet e Teknologjisë së Informacionit

Për periudhën Janar – Qershor 2020 janë evaduar 3 auditime IT.

Instituti i Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;
Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA.

Për periudhën janar - qershor 2020 janë Audituar dhe janë konstatuar në subjektet e paraqitura:

16 Gjetje Rekomandime në subjektin Institutin e Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;

16 Gjetje Rekomandime në subjektin Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;

23 Gjetje Rekomandime në subjektin Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA.

Nga analiza e strukturës së gjetjeve sipas fushave të përcaktuara në metodologjinë e Auditimit TI tregon se edhe për këtë periudhë fushat me problematike të teknologjisë së informacionit ngelen:

1. Qeverisja TI
2. Siguria e Informacionit
3. Zhvillimi dhe blerja

Konkluzione dhe opinioni i Auditimit

Tabela nr.15 Opinionet e auditimeve IT

Subjektet e Audituar	Opinion i Auditimit
KLSH mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH" datë 27.11.2014, ka dhënë opinionet si më poshtë	
Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile	KLSH konstaton se, mos përditësimi për një kohë të gjatë i Planit Kombëtar të Emergjencave Civile, mungesa e vlerësimit kombëtar të riskut dhe mungesa e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut si dhe mos menaxhimi i fazës tranzitore të reformimit që po kalon AKMC, kanë sjellë një situatë me risk të lartë në drejtim të funksionimit dhe


	<p>koordinimit të të gjitha strukturave të emergjencave civile në vend.</p> <p>Identifikimi, përcaktimi, vlerësimi, bashkëpunimi dhe adresimi i burimeve të teknologjisë së informacionit në mbështetje të veprimtarisë së AKMC është i pa pamjaftueshëm.</p> <p>Gjithashtu, AKMC nuk ka konsideruar infrastrukturën kritike të qendëruara të bazave të të dhënave shtetërore si dhe qendrën e të dhënave të cilat jo vetëm janë të vetmet në vend por edhe një investim tejet i lartë në vlerë dhe rendësi.</p> <p>Në gjykimin tonë ekzistenca e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, nën varësi të ministrit, e kufizon atë në ushtrimin e një roli të fortë koordinues ndaj institucioneve të tjera.</p> <p>Për kapërcimin e problematikave të konstatuara në këtë raport dhe rritjes së rolit të IT në përmbushje të objektivave të Agjencisë është rekomanduar hartimi i Strategjisë Institucionale ku pjesë e saj të bëhen edhe elementët e teknologjisë së informacionit.</p>
<p>Instituti i Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;</p>	<p>KLSH konstaton se, Ushtrimi i aktivitetit të IGJEUM me 67.6 % të organikës, dhe përdorimi i Teknologjisë së Informacionit pa strukturë IT, mbart risk në plotësimin e detyrave institucionale si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studimi dhe vlerësimi i fenomeneve gjeologjike e burimeve natyrore të vendit; - Vlerësimi i riskut sizmik, meteorologjik dhe hidrik në shkallë lokale dhe kombëtare; - Monitorimi 24/7 i aktivitetit sizmik, meteorologjik dhe hidrik të vendit, duke mundësuar shpërndarjen e të dhënave në kohë reale për vendimmarrësit dhe opinionin e gjerë. <p>Mungesa e akteve rregullatore, mos trajtimi dhe zgjidhja e problematikave të shfaqura, ka sjellë situatë me risk të lartë në drejtim të sigurisë së të dhënave. Mungesa e gjurmës së auditimit nuk jep siguri të arsyeshme mbi rregullshmërinë e përdorimit të sistemeve në IGJEUM.</p> <p>Ekzistenca e IGJEUM nën varësinë e Universitetit Politeknik të Tiranës, i cili ka si qëllim kryesor përmirësimin e aktivitetit universitar, ka ndikuar në një mungesë të theksuar të vëmendjes për krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin pa ndërprerje të monitorimit të aktivitetit sizmik,</p>

	<p>meteorologjik dhe hidrologjik, objekti i cili në mungesë mund të ndikojë në jetë njerëzish dhe dëme materiale tejet të konsiderueshme.</p> <p>Mungesa e vëmendjes ndaj IGJEUM evidentohet dukshëm në gjendjen e stacioneve të shpërndara në të gjithë territorin e vendit, të cilat rrezikojnë të mos përmbushin plotësisht objektin e tyre, ose të dëmtohen në mënyrë të pariparueshme.</p>
Ujësjiellës Kanalizime Fier SHA	<p>KLSH konstaton se, Ujësjiellës Kanalizime Fier SHA ka zhvilluar sisteme të Teknologjisë së Informacionit pa hartuar bazën e nevojshme rregullatorë për funksionimin e tyre dhe të pa mbështetura me burimet e nevojshme njerëzore. Investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur përfundimisht problemet e sigurisë së informacionit, sigurimin e Vazhdueshmërisë së Biznesit dhe nuk kanë siguruar Rimëkëmbjen nga Katastrofat. Zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës duhet të mbështetet në praktikat më të mira si dhe rekomandimet e AKSHIT.</p> <p>Të dhënat e ruajtura në sistemet nuk janë të sigurta. Gjenerimi i faturave nga UKF Sh.a. është në kundërshtim me Ligjet Tatimore. Sistemet TI janë të kompromentuar nga mungesa e Strategjisë TI, dhe mbartin riskun e keq adresimit të burimeve të limituara financiare që ka UKF Sh.a. për mbështetje e veprimtarisë së saj.</p>

VI. REKOMANDIMET SIPAS NATYRËS

KLSH, gjatë periudhës Janar – Qershor 2020, ka adresuar rekomandime për institucionet publike të audituara. Rekomandime për ndryshime apo përmirësime ligjore, organizative, administrative dhe disiplinore gjithsej janë 989, nga të cilat: 5 janë përmirësime ligjore, 236 rekomandime disiplinore dhe administrative dhe 748 rekomandime organizative.

Grafik nr.15 Masat e rekomanduara nga KLSH për periudhën Janar- Qershor 2020



Burim KLSH


6.1 Masat disiplinore

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara ka adresuar rekomandimet për masat disiplinore dhe administrative, subjekteve të audituara dhe ka bërë publike rezultatet e auditimeve në media-n e shkruar dhe atë elektronike. Gjithashtu, për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit të mësipërm, Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", neni 58 dhe Kodin e Punës, KLSH u ka kërkuar organeve respektive shqyrtimin dhe marrjen e 236 masave disiplinore dhe administrative, si më poshtë:

Tabela nr. 16 Masat disiplinore dhe administrative


	Masa disiplinore bazuar në:	Në numër
I	Ligjin nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", neni 58:	75
	Vërejtje	11
	Mbajtja deri 1/3 të pagës	17
	Pezullim ngritje në detyrë	3
	"Largim nga shërbimi civil"	1
	Në kompetencë të titullarit (Nga Vërejtje deri në largim nga shërbimi civil)	43
II	Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës:	131
	Vërejtje	59
	Vërejtje më paralajmërim	24
	Zgjidhje Kontratës së Punës	11
	Në kompetencë të titullarit (Nga Vërejtje deri në largim nga puna)	37
III	Masat Administrative:	30
	Kompetencë të APP-së, IMTV-së, etj.	29
	Ministresë, Linjës, Heqje Licence	1
IV	Shuma (I+II+III)	236

Grafik nr 17 Masa disiplinore bazuar në Ligjin nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil"




Burimi KLSH

Grafik nr 18 Masa disiplinore bazuar në Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës



Burimi KLSH

Grafik nr. 19 Masat disiplinore dhe administrative të rekomanduara nga KLSH për periudhën Janar- Qershor 2020



Burimi KLSH

Masat disiplinore dhe administrative janë pasqyruar në mënyrë më të detajuar në formularin nr. 4, bashkëlidhur këtij Buletini statistikor.

6.2 Masat për ndryshime apo përmirësime ligjore dhe masat organizative

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2020 janë rekomanduar nga KLSH 753 rekomandime, për ndryshime apo përmirësime ligjore dhe masa organizative.

KLSH ka rekomanduar gjithsej 5 propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore, ndryshime që prekin nga rekomandime për amendime në korniza ligjore, raportimin financiar por edhe në përmirësime të kuadrit të brendshëm rregullativ të institucioneve me synim forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike etj.

Gjithashtu KLSH ka rekomanduar 748 masa organizative, në drejtim të forcimit të menaxhimit financiar dhe sistemeve të kontrollit.

Rekomandime për ndryshime apo përmirësime ligjore dhe masat organizative janë pasqyruar në mënyrë më të detajuar në formularin nr. 5 dhe 5.1, bashkëlidhur këtij Buletini Statistikor.

VII. Kallëzimet Penale

KLSH ka luftuar pa kompromis ndaj abuzimeve dhe mashtrimeve financiare me pronën publike, duke synuar përmirësimin e qeverisjes publike nëpërmjet thellimit të luftës pa kompromis ndaj zyrtarëve të korruptuar, kryesisht adresimin e kallëzimeve penale me akuzat “Shpërdorim detyre”, “Shkelje e barazisë në tendera”, etj.

KLSH nga auditimet e realizuara për gjashtëmujorin e parë të 2020 ka përcjellë 8 kallëzime dhe indicie penale, nga të cilat 5 i janë dërguar prokurorisë si indicie penale, 1 kallëzim penal dhe 2 janë dërguar për vlerësim në Prokurori.

Kallëzim Penal dhe Indicie Penale

- 1) Instituti i Monumenteve të Kulturës (*Indicie për ndjekje penale*);
- 2) Prefektura e Qarkut Tiranë (*Indicie për ndjekje penale*);
- 3) Bashkia Finiq (*Ish-Kreytar i Bashkisë Finiq, në cilësinë e ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Ish Përgjegjës në Sektorin e Procedurave të Prokurimit, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT dhe cilësinë e Kryetarit të KVO*), *Ish përgjegjës në sektorin juridik, në cilësinë e anëtarit të NJHDT dhe cilësinë e Kryetarit të NJHDT*);

- 4) Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet (*Ish-Regjistruer, në ish-Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme {aktualisht Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës}, Ish-Regjistruer, Ish specialist hartograf*);
- 5) Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastrë (*Ish-drejtor në Ish-Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Ish-drejtor në Ish-Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit në ish-Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Qarku Gjirokastrë*);
- 6) Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" (*Vlerësim të mëtejshëm nga Prokuroria të Raportit Përfundimtar të Auditimit*);
- 7) Ujësjetës Kanalizime Kavajë SH.A (*Indicie për ndjekje penale*);
- 8) Porti Detar Vlorë SH.A (*Për vlerësim të mëtejshëm nga Prokuroria dhe vijëmbesi të Indicies Penale 1133/15 datë 17.12.2018*).

Për 8 kallëzimet penale/indicie penale të përcjella në Prokurori janë kallëzuar 10 persona të konstatuar me shkelje të rënda nga auditimet e KLSH-së.

Anekse

Evidenca nr.1

Institucionet e evaduara nga KLSH, gjatë periudhës Janar – Qershor 2020

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT TË SHETETIT		
1	1	Dega Doganore Durrës
2	2	Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INSTITUCIONEVE QENDRORE		
3	1	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik
4	2	Instituti i Monumenteve të Kulturës
5	3	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit
6	4	Inspektorati Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
7	5	Instituti i Statistikave
8	6	Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara (ABP)
9	7	Ministria e Kultures
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETQEVERISJES VENDORE		
10	1	Bashkia Rogozhinë
11	2	Agjencia për mbështetjen e vetqeverisjes Vendore (AMVV)
12	3	Bashkia Skrapar
13	4	Bashkia Finiq
14	5	Bashkia Divjakë
15	6	Këshilli i Qarkut Gjirokastër
16	7	Prefektura e Tiranës
17	8	Bashkia Roskovec
18	9	Bashkia Malësia e Madhe
19	10	Bashkia Maliq
20	11	Bashkia Cërrik
21	12	Bashkia Ura Vajgurore
22	13	Zbatimi i rekomandimeve në 12 subjekte (bashkitë Kurbin, Tropojë, Librazhd, Pukë, Mat, Bulqizë, Gramsh, Fushë Arrëz, Tiranë, Tirana Parking, Drejtoria e punëtorëve të qytetit Tiranë Nr,2.
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETIVE, DHE MJEDISIT		
23	1	Drejtoria Vendore e ASHK Mirditë
24	2	Drejtoria Vendore e ASHK Përmet
25	3	Drejtoria Vendore e ASHK Sarandë
26	4	Drejtoria Vendore e ASHK Mallakastër
27	5	Zbatim i rekomandimeve në subjektet e evaduara gjatë vitit 2019
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOOËRIVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE TË HUAJA		
28	1	Rezidencën Studentore Nr.2 SHA Tiranë
29	2	Portin Detar Shëngjin SHA
30	3	Portin Detar Vlorë SHA
31	4	Ujësjellës Kanalizime SHA Kavajë

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT		
32	1	Instituti i Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
33	2	Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
34	3	Ujësjetës Kanalizime Fier SHA

Evidenca nr.1.1

Auditimet në proces për periudhën Janar-Qershor 2020

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT		
1	1	Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Mbi Raportin e Zbatimit të Buxhetit për vitin 2019)
2	2	Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtorja e Përgjithshme e Borxhit Publik)
3	3	Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtorja e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik)
4	4	Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit)
5	5	Banka e Shqipërisë
6	6	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
7	7	Dega Doganore Tiranë
8	8	Drejtorja e Përgjithshme e Doganave
9	9	Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve
10	10	<i>Auditim Performance me temë:</i> Ecuria e Borxhit Tatimor
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INSTITUCIONEVE QËNDRORE		
12	1	Entin Rregullator të Ujit
13	2	Ministria e Brendshme
14	3	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – Konkensionit i Labotarëve spitalorë
15	4	Ministria e Mbrojtjes
16	5	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
17	6	Fondin Shqiptar i Zhvillimit
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETOEVERISJES VENDORE		
18	1	Drejtorja e Përgjithshme Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë
19	2	Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë
20	3	Bashkia Dibër
21	4	Bashkia Peqin
22	5	Bashkia Kuçovë
23	6	Bashkia Konispol
24	7	Drejtorja e Rajonit Qendror, Tiranë, ARRSH
25	8	Bashkia Korçë
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETIVE, DHE MJEDISIT		
26	1	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Tiranë (Qendër)
27	2	Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Njësitë e varësisë

28	3	Drejtoria Vendore ASHK Korçë
29	4	Drejtoria Vendore ASHK Pukë
30	5	Drejtoria Rajonale e Rrugëve - Veriu Shkodër
31	6	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Lezhë (ish DRM dhe DR ISHMPUT)
32	7	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Vlorë (ish DRM dhe DR ISHMPUT)
33	8	<i>Auditim Performance me temë: "Efektiviteti i masave të marra për përmirësimin e sistemit të regjistrimit dhe administrimit të pasurive të paluajtshme"</i>
34	9	<i>Auditim Performance me temë: "Efektiviteti i Procesit të Legalizimit dhe ndikimi në administrimin e pasurisë publike"</i>
		DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOOËRIVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE TË HUAJA
35	1	Zbatimi i Rekomandimeve të lëna nga KLSH për auditimet e evaduara në vitin 2019
36	2	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA
37	3	Operatori i Sistemit të Transmetimit SHA
38	4	AlbPetrol SHA
39	5	Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës
40	6	Albgaz SHA
41	7	Radio Televizioni Shqiptar
42	8	Projekti "Zhvillimi i sektorit privat" në Ministrinë e Financave
43	9	Projekti: "Zhvillimi i integruar urban dhe turizmi" në FSHZH
44	10	Projekti: "Eficienca në energji" në OST SHA
45	11	Projekti: "Bulevardi verior dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës"
46	12	<i>Auditim performance me temë: Detyrimet e ndërsjellta KESH-OSHEE-OST</i>
		DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
47	1	<i>Auditim performance me temë: Trajtimi i fëmijëve ndryshe</i>
48	2	<i>Auditim performance me temë: Menaxhimi i mbetjeve plastike</i>
49	3	<i>Auditim performance me temë: Eficienca e energjisë</i>
50	4	<i>Auditim performance me temë: Gjobat për shkelje të Kodit Rrugor vendosur nga Policia e Shtetit</i>
51	5	<i>Auditim performance me temë: Ndotja e menjëhershme e Adriatikut</i>
52	6	<i>Auditim performance me temë: Efektiviteti i politikave qeveritare me lëvizjet migratore të popullsisë</i>
53	7	<i>Auditim performance me temë: Efektiviteti i procesit të integritimit në BE</i>
		DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT
54	1	Auditimi i sistemeve TI në Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA
55	2	Auditimi IT në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave

Evidenca nr.2

Evidenca përmblledhëse e shkeljeve me dëm ekonomik të konstatuar gjatë auditimeve të ushtruara për të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën
Janar – Qershor 2020

Mijë lekë

Nr.	Subjektet	Gjithsej Zbuluar	Rekomanduar për zhdëmtim	Të pa arkëtueshme
1	Instituti i Monumenteve të Kulturës	697	697	
2	Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP)	209,677	209,677	
3	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	33,281	33,281	
4	Dega e Doganës Durrës	453,211	453,211	
5	Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	1,444	1,444	
6	Bashkia Rrogozhinë	190,021	190,021	
7	Bashkia Finiq	77,384	77,384	
8	Bashkia Divjakë	15,733	2,511	13,222
9	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	801	801	
10	Bashkia Cërrik	9,789	9,789	
11	Bashkia Skrapar	5,296	5,296	
12	Bashkia Ura Vajguore	42,162	42,162	
13	Bashkia Malësi e Madhe	14,572	9,500	5,072
14	ZVASHK Mirditë	23,421	23,421	
15	ZVASHK Përmet	1,822	1,822	
16	DVASHK Sarandë	969,084	969,084	
17	ZVASHK Mallakastër	23,184	23,184	
18	Rezidenca Studentore nr. 2 Tiranë SHA	1,194	1,194	
19	Porti Detar Shëngjin SHA	929	929	
20	Porti Detar Vlorë SHA	3,935	3,935	
21	Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA	101,261	101,261	
	Totali	2,178,898	2,160,604	18,294

Evidenca nr. 3

Evidenca e pasqyrimin të parregullsive të dispozitave ligjore në fuqi, për të ardhura të munguara ose shpenzime jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit, të cilat kanë sjell efekt negativ financiar në të ardhurat e subjekteve dhe buxhetin e shtetit për periudhën
Janar – Qershor 2020

Mijë lekë

Nr.	Emërtimi i subjekteve	A Shuma në të ardhura	B Shuma në shpenzime	TOTALI
1	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik	3,711	1,240	4,951
2	Instituti i Monumenteve të Kulturës	0	8,405	8,405
3	Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP)	0	210,052	210,052
4	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	0	166,182	166,182

5	Ministria e Kulturës	0	45,700	45,700
6	Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	0	35,229	35,229
7	Bashkia Rogozhinë	221,658	0	221,658
8	Bashkia Finiq	161,232	139,375	300,607
9	Prefektit te Qarkut Tiranë	67,707	14,399	82,106
10	Bashkia Divjakë	12,325	2,123	14,448
11	Agjencia për Mbështetjen e vetqeverisjes Vendore (AMVV)	0	3,338	3,338
12	Bashkia Cërrik	0	10,599	10,599
13	Bashkia Skrapar	89,263	9,369	98,632
14	Bashkia Ura Vajgurore	246,729	343,492	590,221
15	Bashkia Malësi e Madhe	141,083	130,644	271,727
16	Bashkia Roskovec	111,865	5,409	117,274
17	Rezidenca Studentore nr. 2 Tiranë SHA	0	77,443	77,443
18	Porti Detar Shëngjin SHA	2,431	5,092	7,523
19	Porti Detar Vlorë SHA	195	5,891	6,086
20	Ujësjetllës Kanalizime Kavajë SHA	0	4,307	4,307
	Totali	1,058,199	1,218,289	2,276,488

Evidenca nr.4

Evidenca e Masave Disiplinore dhe Administrative të rekomanduara nga KLSH për periudhën Janar – Qershor 2020

Në numër

Nr	Emërtimi i subjekteve	GITHSEJ MASAT		
		A) ME STATUSIN E NEPUNESIT CIVIL	B) ME KODIN E PUNES	C) MASAT ADMINISTRATIVE
		Rek	Rek	Rek
1	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	10	0	0
2	Dega e Doganës Durrës	28	0	0
3	Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	1	5	1
4	Bashkia Rogozhinë	0	0	0
5	Bashkia Finiq	4	8	6
6	Prefektit te Qarkut Tiranë	9	0	6
7	Bashkia Divjakë	0	0	0
8	Këshilli i Qarkut Gjirokastër	0	1	3
9	Agjencia për Mbështetjen e vetqeverisjes Vendore (AMVV)	0	0	0
10	Bashkia Cërrik	1	1	6
11	Bashkia Skrapar	9	14	1
12	Bashkia Ura Vajgurore	0	0	1
13	Bashkia Malësi e Madhe	4	15	0
14	Bashkia Roskovec	9	14	1

15	Rezidenca Studentore nr. 2 Tiranë SHA	0	15	0
16	Porti Detar Shëngjin SHA	0	11	0
17	Porti Detar Vlorë SHA	0	9	5
18	Ujësjetës Kanalizime Kavajë SHA	0	0	0
19	ZVASHK Mirditë	0	2	0
20	ZVASHK Përmet	0	4	0
21	DVASHK Sarandë	0	14	0
22	ZVASHK Mallakastër	0	18	0
TOTALI		75	131	30

Evidenca nr.5

Masat për ndryshime apo përmirësime ligjore dhe masa organizative të rekomanduara nga KLSH për periudhën Janar – Qershor 2020

Në numër

	SUBJEKTI	Ndryshime dhe përmirësime legjislatoni
		Rekomanduar
1	Instituti i Monumenteve të Kulturës	1
2	Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP)	4
TOTALI		5

Evidenca nr.5.1

Masat Organizative të rekomanduara nga KLSH për periudhën Janar – Qershor 2020

Në numër

Nr	SUBJEKTI	Masa organizative	Masa mungesa të ardhurash	Masa eliminim 3E	Masa per eliminimin e paligjshmerisë
		Rek.	Rek.	Rek.	Rek.
1	Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik	17		6	
2	INSTAT	15			
3	Instituti i Monumenteve të Kulturës	15		3	
4	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore	8		7	
5	Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP)	3		8	
6	Drejtoria e Shërbimit Kombëtar i Punësimit	18		2	
7	Ministria e Kulturës	14			
8	Dega e Doganës Durrës	5			

9	Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	6		5	
10	Bashkia Rogozhinë	10	7	4	
11	Bashkia Finiq	18	7	4	
12	Prefektit të Qarkut Tiranë	7			
13	Bashkia Divjakë	23			
14	Këshilli i Qarkut Gjirokastër	10			
15	Agjencia për Mbështetjen e vetqeverisjes Vendore (AMVV)	14			
16	Bashkia Cërrik	14			
17	Bashkia Skrapar	10	2	3	
18	Bashkia Ura Vajgurore	18	3	1	1
19	Bashkia Malësi e Madhe	17	5	2	
20	Bashkia Maliq	13		9	
21	Bashkia Roskovec	10	2	3	
22	ZVASHK Mirditë	52			
23	ZVASHK Përmet	30			
24	DVASHK Sarandë	46			
25	ZVASHK Mallakastër	63			
26	Rezidenca Studentore nr. 2 Tiranë SHA	47			
27	Porti Detar Shëngjin SHA	21			
28	Porti Detar Vlorë SHA	34			
29	Ujësjiellës Kanalizime Kavajë SHA	51			
30	Instituti i Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IT)	16			
31	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (IT)	16			
32	Ujësjiellës Kanalizime Fier SHA (IT)	23			
	TOTALI	664	26	57	1

EVIDENCA E KALLËZIMEVE PENALE PËR PERIUdhËN JANAR – QERSHOR 2020

Nr.	Subjekti ndaj të cilit është bërë kallëzimi	Nr.prot. data e kallëzimit	Nr. Pers	Detyra funksionale	Referenca ligjore për kallëzim penal	Gjendja e kallëzimit	Departamenti që ka konstatuar veprën penale
1	Instituti i Monumenteve të Kulturës	Nr.66/9 Datë 22/06/2020			Indicie për ndjekje penale	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore
2	Prefektura e Qarkut Tiranë	Nr 1017/9 Datë 08/05/2020			Indicie për ndjekje penale	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Vetqeverisjes Vendore
3	Bashkia Finiq	Nr.Prot 1048/15 Në datë 11.05.2020	3	1) Ish-Kryetari Bashkisë Finiq, në cilësinë e ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor 2) Ish Përgjegjës në Sektorin e Procedurave të Prokurimit, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT dhe cilësinë e Kryetarit të KVO 3) Ish përgjegjës në sektorin juridik, në cilësinë e anëtarit të NJHDT dhe cilësinë e Kryetarit të NJHDT	Konsumim i figurës së veprës penale " Të Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike" parashikur nga neni 258 i Kodit Penal, " Falsifikimi i dokumenteve" parashikuar nga neni 186 i KP dhe "Hyrja e pautorizuar kompjuterike" parashikuar nga neni 192/b i KP	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Vetqeverisjes Vendore
4	Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet	Nr.Prot 901/18 Në datë 30.06.2020	3	1) Ish-Regjistruer, në ish-Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (aktualisht Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës), Përmet 2) Ish-Regjistruer 3) Ish specialist hartograf	Indicie për ndjekje penale lidhur me shkeljet e konstatuara në ish-Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (aktualisht Zyra Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës) Përmet	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit
5	Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të	Nr.Prot 901/19 Në datë 30.06.2020	3	1) Ish-drejtor në Ish-Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Qarku Gjirokastrë	Indicie për ndjekje penale lidhur me shkeljet e konstatuara në ish-Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (aktualisht Zyra Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës) Përmet për pjesën e miratimit të lejeve të legalizimit nga ish-Drejtoria Rajonale	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit

Nr.	Subjekti ndaj të cilit është bërë kallëzimi	Nr.prot. data e kallezimit	Nr. Pers	Detyra funksionale	Referenca ligjore për kallëzim penal	Gjendja e kallëzimit	Departamenti që ka konstatuar veprën penale
	Kadastrës Gjirokastër			2) Ish-drejtor në Ish-Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Qarku Gjirokastër 3) Ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit në ish-Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Qarku Gjirokastër	të Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Qarku Gjirokastër		
6	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"	<i>Nr.Prot 1422/14 Në datë 26.02.2020</i>			Vlerësim të mëtejshëm nga Prokuroria të Raportit Përfundimtar të Auditimit	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja
7	Ujësjetllës Kanalizime Kavajë SH.A	<i>Nr.Prot 1016/8 Në datë 04.06.2020</i>	1	Administratori i Shoqërisë	Indicie për ndjekje penale	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja
8	Porti Detar Vlorë SH.A	<i>Nr.Prot 974/12 Në datë 04.06.2020</i>			Indicie për ndjekje penale Për vlerësim dhe vijëmesi të Indicies Penale me nr.prot 1133/15 datë 17.12.2018	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Evidenca nr. 7

Evidenca e shqyrtimit të ankesave dhe kërkesave drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit Periudha
Janar – Qershor 2020

Shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave	Nr.	Verifikuar e rezultuar		Vazhdon verifikimi	Ardhur jashtë kompetencave të KLSH (nuk verifikohet)
		E drejtë	Pa drejtë		
<i>Fushat kryesore të shqetësimit publik</i>					
Për administrim financiar dhe prokurime	10	10	-	-	-
Administrim dhe kthim prone	82	17	12	15	38
Taksa, Tatime e dogana	-	-	-	-	-
Të tjera	34	22	10	2	-
Total	126	49	22	17	38

